



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1429/8 Prot.

Tiranë, më 28.05.2024

**VENDIM**

Nr. 41 datë 28.05 2024

**PËR**

**PROPOZIMIN E FINANCIMIN E PJESËMARRJES SË UNIVERSITETIT TË  
SPORTEVE TË TIRANËS NË KONFERENCËN E 10-TË SHKENCORE  
NDËRKOMBËTARE TË KINEZIOLOGJISË, FAKULTETI I KINEZIOLOGJISË -  
UNIVERSITETI I ZAGREBIT, KROACI**

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH" neni 3, neni 38, Statutin e UST neni 7, neni 20, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 120 datë 14/11/2023, "Për pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në Konferencën e 10-të Shkencore Ndërkombëtare të Kineziologjisë, Fakulteti i Kineziologjisë / Universiteti i Zagrebit", në Vendimin e Senatit Akademik nr. 136 datë 19/12/2023 "Për nënshkrimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në Konferencën e 10-të Shkencore Ndërkombëtare të Kineziologjisë, Fakulteti i Kineziologjisë / Universiteti i Zagrebit, Kroaci", në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 82 datë 21/12/2023 "Për pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në Konferencën e 10-të Shkencore Ndërkombëtare të Kineziologjisë, Fakulteti i Kineziologjisë / Universiteti i Zagrebit, Kroaci" si dhe në vijim të përfundimit të afatit të aplikimeve për dërgimin e abstrakteve, në vendimin e Rektoratit nr 40 datë 20.05.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 28/05/2024,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin për mbështetje financiare për pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës, si partner në Konferencën e 10-të Shkencore Ndërkombëtare të Kineziologjisë, e cila do të organizohet nga Fakulteti i Kineziologjisë, Universiteti i Zagrebit, Kroaci në datat 12 -15 shtator 2024 në Opatija, Kroaci.
2. Mbështetja financiare të përfshijë:
  - Mbulimin e të gjitha shpenzimeve të pjesëmarrjes së delegacionit të vendosur nga Rektorati i UST-së në zhvillimet e kësaj konference.

- Mbulimin e shpenzimeve të tarifës së pjesëmarrësve, akomodimit dhe transportit për stafin akademik dhe atë kërkimor-shkencor të cilët do të referojnë punimet e tyre shkencore (një autor për një punim).

3. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST-së.

4. *Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.*

**KRYETAR**

**Prof. Dr. Agron KASA**

